



Projekt i financuar nga
Bashkimi Evropian



Save the Children

Shembuj të aplikimit të Udhërrëfyesit gjatë punës me fëmijët me aftësi të kufizuar

Tiranë, 2017

Ky publikim u përgatit në kuadër të Projektit “Të mbrojmë të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar në Shqipëri” i zbatuar nga Shoqata “Ndihamoni Jetën” pjesë e Projektit “Përfshirja e Shoqërisë Civile në Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terre des Hommes në Shqipëri.

1 Hyrje

Ky session përmban dokumentimin e disa sjelljeve të papërshtatshme të shfaqura në qendra të cilat ofrojnë shërbime ditore dhe rezidenciale. Përgjatë periudhës së pilotimit stafet u angazhuan edhe në aplikimin e këtyre formateve për të dokumentuar dhe për të realizuar analizën e sjelljes me qëllim hartimin e strategjive të ndërhyrjes në mënyrë të menjëhershme.

Analiza e sjelljes na jep informacion duke e pasqyruar sjelljen në detaje por edhe për të identifikuar funksionin e sjelljes dhe arysen për të cilën personi me AK po e përdor atë. Në varësi të të kuptuarit të funksionit të sjelljes ne marrim kohën e duhur përmes dokumentimit të sjelljes. Nisur nga funksioni dhe motive disa sjellje kërkojnë një kohë më të gjatë për tu vëzhguar e disa të tjera marrin kuptim më shpejt në kohë.

Ndërkohë aplikimi i formateve përcaktohet gjithashtu nga problematika e sjelljes së shfaqur por edhe nga shtrirja në kohë e sjelljes dhe mënyra sesi sjellja shfaqet dhe dinamikat e saj.

Referuar rasteve më poshtë vlen të përmendet se koha e dokumentimit nuk është e mjaftueshme për të bërë analizën e plotë të sjelljes, për të kuptuar shkallën e motivit dhe funksionin e sjelljes. Raste janë konsideruar si modele të cilat do të ndihmojnë dhe orientojnë në vazhdimësi stafet të cilat do ju duhet ti përdorin këto formate në punën e tyre të përditshme dhe sa herë gjenden të sfiduar nga shfaqja e sjelljeve të papërshtatshme dhe të vështira për tu trajtuar. Secila sjellje e konsideruar e papërshtatshme sipas udhëzimeve të Udhërrefyesit është e nevojshme të dokumentohet dhe të analizohet por duhet të kemi parasysh se disa sjellje të cilat kanë origjinë shqetësimet fizike dhe që konstatohen lehtësisht, koha e vëzhgimit sigurisht që do të jetë më e ulët. Ndërkohë analiza e shkallës së motivit realizohet në analizën e realizuar nga ekipi në fund të kohës së dokumentimit.

Qëllimi i prezantimit të këtyre rasteve është vetëm ofrimi i modelit të dokumentimit të sjelljes për ta lehtësar procesin teksa do duhet ta aplikojnë të gjithë stafet që ofrojnë shërbime për fëmijët me AK në qendrat rezidenciale dhe ditore.

Zgjedhja e formateve është sa e kornizuar po aq edhe e lirë në gjykimin tuaj profesional duke vëzhguar sjelljen. Duke gjykuar mbi kohën dhe mudësinë për ti aplikuar për të mos cënuar kohën e dedikuar manaxhimit të rastit është me shumë rëndësi ti konsideroni patjetër këto formate pasi janë instrumenta që do e orientjnë shërbimin tuaj drejt standarteve profesionale.

Rasti Nr. 1

Aneks II

Përmbledhja e modelit të Vlerësimit Funkcional të Sjelljes

Mbledhja e informacionit ndihmon për hartimin e një plani për ndryshimin e sjelljes. Ky informacion duhet të mblidhet nga punonjësit që janë në kontakt me fëmijën, në bashkëpunim me terapistin e sjelljes dhe prindërit/kujdestarët.

Pyetjet e mëposhtme ndihmojnë për të marrë informacionin e nevojshëm që do përdoret për analizën e sjelljes:

- **Cila është sjellja? Vëzhgoni, emërtoni dhe përshkruani sjelljen.**
K ka filluar të shfaqë disa sjellje të cilat nuk i ka shfaqur më herët. K nuk ka vështirësi në bashkëpunim madje angazhohet me shumë dëshirë dhe arrin të realizojë performancë të sakta. A nuk bën rezistencë ndaj detyrave të reja dhe kur ato kanë shkallë vështirësie të konsiderueshme krahasuar me kapacitete dhe aftësitë e saj për ta realizuar. Ndërkohë u vu re një shqetësim i saj i shprehur në mnëyrë intensive. Teksa është duke punuar, teksa është pa vëmendje apo angazhim, duke udhëtuar, duke konsumuar drekën apo kudo tjetër papritur fillon të qajë, godet kokën e saj, pickon krahët dhe lëshoi zëra të fortë dhe mjaft shqetësues. Mbyll veshët , shtrëngon kokën, kafshon dorën dhe gjithashtu pas disa sekondash bëhet aggressive me terapistin. Kjo është një situatë e cila ka filluar të shfaqet si fillim në familje por është parë nga prindërit si dicka që mund të kalojë. Sipas tyre e kanë privuar nga konsumimi i disa lëngjeve me gas si coca-cola dhe përmes sjelljes mendojnë se po bën kërkesë për lëngun. Por ne duhet të vëzhgojmë dhe analizojmë sjelljen për të dalë në një konkluzion të përshtatshëm. Teksa qëndron në qëndër u evidentua se sjellja e saj është mjaft shqetësuese dhe se K përmes fjalëve po përpiqet ta shprehë çfarë ndjen. K përmend vazhdimisht koka- koka dhe duke iu drejtuar terapistes në sy i tregon me gisht ballin si për ta plotësuar të shprehurin e shqetësimin.
- **Ku ndodhi sjellja? Përshkruani vendin apo mjedisin ku ndodhi sjellja.**
Sjellja ndodhi në klasë teksa ishte ulur dhe po zhvillohej programi në kushte qetësie. Por nuk ka një vend të caktuar ku K shfaq këtë sjellje shqetësuese

- **Kush u përfshi në kohën kur ndodhi sjellja? Shkruani emrat e personave që ishin në mjedis para, gjatë dhe pas shfaqjes së sjelljes.**
Terapistja e grupit pasi isha prezente ne ato momente
- **Kur ndodhi sjellja? Përcaktoni kohën kur sjellja shfaqet zakonisht.**
Kam vënë re se K nuk zgjedh një moment të caktuar për të shfaqur këtë sjellje dhe madje e përsërit shpesh përgjatë ditës
- **Pse ndodhi sjellja? Bëni hipoteza për funksionet ose shkaqet e sjelljes.**
Nga sa e kam vëzhguar mendoj se sjellja e saj lidhet me shqetësime fizike dmth dhimbje të kokës. Është vënë re se kur është e qetë K angazhohet pa vëshitrësi dhe me dëshirë.
- **Përcaktoni çfarë ndodhi para dhe pas shfaqjes së sjelljes.**
K ishte ulur në tavolinë si zakonisht, dhe papritur nisi të shafqi sjelljen më sipër. Teksa bëri këto veprime u fokusua tek terapistja dhe duket sikur kërkoi të shprehi gjithë shqetësimin, madje u bë aggressive pas disa sekondash gjatë të cilave bëritit, goditi veten, kafshoi dorën dhe përmendte koka duke e treguar me gisht tek pjesa e ballit.
- **Merrni në konsideratë funksione të ndryshme të sjelljes. Studiuesit kanë përcaktuar tre funksione kryesore të sjelljeve sfiduese: 1) për të marrë vëmendje ose gjëra të tjera të dëshiruara (dëshira dhe nevoja); 2) për të shmangur ngjarje ose aktivitete të padëshiruara; 3) si një përgjigje ndaj përjetimit fizik ose ndjesor (dhimbje, mosrehati ose për t'u ndjerë mirë).**
Mendoj se funksioni i kësaj sjellje ishte si një përgjigje ndaj shqetësimit fizik.
- **Sa shpesh ndodh sjellja problematike?**
Sjellja u përsërit shpesh herë gjatë ditës, zgjat 2-3 minuta dhe në distance kohore të shkurtra nga njëra tjetra. Sjellja aktivizohet edhe kur duket se është e qetë dhe e angazhuar.
- **Çfarë ndodh kur fëmijës i mësohet një sjellje zëvendësuese/e re, kur mjedisi ndryshon ose faktorët nxitës largohen?**
Është e dukshme që nuk ka faktor të jashtëm që nxisin sjelljen e K megjithatë si terapistë kujdesem ti ofroj mbështetje, ta qetësoj por kam vënë re se ajo kërkon disa minuta për tu qetësuar dhe sjellja mund të nisi sërish pas disa minutash.

Aneks III

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike ndihmon në përcaktimin e faktorëve nxitës dhe faktorëve shpërblimi që merr fëmija nga një sjellje që mund ta përforcojë ose ta mbajë sjelljen problematike.

Emri i fëmijës: K.M.

Data	Koha	Stafi	Faktori Nxitës (Çfarë ndodhi më parë?)	Sjellja (Përshkruani sjelljen)	Pasoja/Shpërblimi (Çfarë ndodhi më pas?)
04/09/2017	Në autobuzin e transportit të qëndrës	Terapistja e grupit	Asgje e vecnatë, fëmijët ishin të qetë dhe itenerari ishte ai i zakonshmi. Ishte vendosur pak muzike dhe dukej se po e shijonin.	Nisi të tundet para- mbrapa dhe hedhje të fuqishme në sedilje, nisi të bërtasë, kafshoi dorën pas pak sekondash piskoi shoken që ishte ulur ngjitur me të	Terapistja dhe mbështetja në transport asistuan deri në qetësimin e saj pas 1-2 minutashU qetësua dhe kërkoi ti bëhet xhan duke zgjatur dorën terapistes.
04/09/2017	Në grup duke ndjekur programin	Terapistja e grupit	Po realizonte një puzzle me rreth 35 pjesë. Ishte e qetë dhe e përqëndruar. Ndërkohë edhe pjesa tjetër e grupit po punonin me qetësi. Dëgjoreshin vetëm instruksionet e terapistes.	Filloi të bëj lëvizje të pakontrolluara të duarve, hidhej dhe tundej në karrike, bëriste, kafshoi dorën dhe u ngrit të qëllori terapisten e ulur përballë në tavolinën e përbashkët. Vihet re se edhe shikimi nuk është i kordinuar.	Iu ofrua mbështetje për ta qetësuar dhe u ndihmua të tregoj me gisht nëse ka dhimbje duku. Nuk u qetësua menjëherë por mori rreth 2 minuta kohë. Pas kësaj vazhdoi të punojë sikur asgjë si kishte ndodhur

04/09/2017	Në grup sërish	Terapistja e grupit	Po vazhdonte të plotësonte puzzle.	I njëjti episode i sjelljes u shfaq sërish dhe me po ato elemente.	U ndoq e njëjta rrugë deri në qetësimin e saj. E pleta nëse dëshiron të dilnim pak jashtë apo të pinte pak ujë por me reagimet e saj refuzoi të ngrihej teksa kryente këtë sjellje. Pas 2 minutash u qetësua dhe vazhdoi sërish të angazhohej në tavolinë. U komunikua me prindërit të cilët sugjeruan një medicament të thjeshtë me efekt qetësimi të dhimbjeve nëse kishte.
04/09/2017	Në mensë	Terapistja e grupit N d i h m ë s kuzhinierja	Po zhvillohej program i terapise okupacionale ku K dhe pjesa tjetër e grupit ndihmojnë duke pastruar perimet që do konsumohen në vaktin e drekës.	Sjellja u shfaq sërish por agresiviteti ndaj stafit ishte me i fortë, duke i pickuar dhe duke lëshuar zëra shumë të forte, me shtrëngime të kokës dhe vetëdëmtim të kokës e kafshim të dorës.	U punua për qetësimin e saj, duke i ofruar mbështetje pasi kuptohej se ka një shqetësim fizik. Situata vazhdoi ashtu , duke marrë rreth 3-4 minuta deri në qetësimin e saj. Pas kësaj u qetësua dhe u ul. Refuzoi të ndërroj ambient në ato moment thjesht vazhdoi aty ku e kishte lënë.

Aneks IV

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike –Modeli i shkurtuar

Faktori nxitës	Sjellja	Pasoja/Shpërblimi
<p>Kohëzgjatja e ngjarjes: 3 min</p> <p>___ Jepet detyra</p> <p>___ Drejtuesi kërkon të bëhet një detyrë</p> <p>___ Asnjë aktivitet</p> <p>___ Koha e zgjimit</p> <p>___ X_ Pa vëmendje</p> <p>___ Tjetër: koha e udhëtimit për në qendër</p>	<p>___ Sjellja</p> <p>___ X_ Refuzim (injonon udhëzimet)</p> <p>x_ Agresion verbal (bërtitje)</p> <p>x_ Të qara</p> <p>___ X_ Ankesa për dhimbje</p> <p>___ Shkatërrim i pronës (prishja e sendeve, hedhja e gjërave, përplasja e detyrve, etj.)</p> <p>___ X_ Agresion kundër të tjerëve (shtyrje, goditje me sende, goditje me grushta, shqelma, etj.)</p> <p>___ Arratisje (i kja nga dhoma, etj.)</p> <p>X Tjetër: Agresion përkundrejt vetes</p>	<p>___ Riudhëzim verbal</p> <p>___ Injorim</p> <p>___ Shpërblim</p> <p>___ Përsëritje e kërkesës</p> <p>___ Ndërprerje e detyrës</p> <p>___ Ndalim i sjelljes</p> <p>___ Sjellja përshkallëzohet</p> <p>___ Fiton akses në aktivitetet</p> <p>___ Vëmendje e fituar nga stafi/ të tjerët</p> <p>___ Tjetër: Qetësim por që zgjat pak në kohë për tu aktivizuar sjellja sërisht.</p>
<p>Kohëzgjatja e ngjarjes: 5 minuta</p> <p>___ Jepet detyra</p> <p>___ Drejtuesi kërkon të bëhet një detyrë</p> <p>___ Asnjë aktivitet</p> <p>___ Koha e zgjimit</p> <p>___ X_ Pa vëmendje</p> <p>___ Tjetër: duke punuar individualisht dhe me interes për konstruksionin që po realizonte</p>	<p>___ Refuzim (injonon udhëzimet)</p> <p>x_ Agresion verbal (bërtitje)</p> <p>___ X_ Të qara</p> <p>___ X_ Ankesa për dhimbje (konsiderohen shtrengimet e kokës të shoqeruara me ndonjë fjale here pas here, koka)</p> <p>___ Shkatërrim i pronës (prishja e sendeve, hedhja e gjërave, përplasja e detyrve, etj.)</p> <p>___ X_ Agresion kundër të tjerëve (shtyrje, goditje me sende, goditje me grushta, shqelma, etj.)</p> <p>___ Arratisje (i kja nga dhoma, etj.)</p> <p>___ Tjetër: Agresion drejtuar vetes</p>	<p>___ Riudhëzim verbal</p> <p>___ Injorim</p> <p>___ Shpërblim</p> <p>___ Përsëritje e kërkesës</p> <p>___ Ndërprerje e detyrës</p> <p>___ Ndalim i sjelljes</p> <p>___ Sjellja përshkallëzohet</p> <p>___ Fiton akses në aktivitetet</p> <p>___ Vëmendje e fituar nga stafi/ të tjerët</p> <p>___ Tjetër: qetësim i situatës dhe angazhim i menjehershëm</p>

<p>Kohëzgjatja e ngjarjes: 5 minuta</p> <p>__ Jepet detyra</p> <p>__ Drejtuesi kërkon të bëhet një detyrë</p> <p>__ Asnjë aktivitet</p> <p>__ Koha e zgjimit</p> <p>__ Pa vëmendje</p> <p>__ Tjetër: në aktivitet(duke vazhduar konstruksionin me mjaft interes)</p>	<p>__ Refuzim (injoron udhëzimet)</p> <p>__ X_ Agresion verbal (bërtitje)</p> <p>__ X_ Të qara</p> <p>__ X_ Ankesa për dhimbje(konsiderohen shtrëngimet e kokës)</p> <p>__ Shkatërrim i pronës (prishja e sendeve, hedhja e gjërave, përplasja e dyerve, etj.)</p> <p>__ A_ Agresion kundër të tjerëve (shtyrje, goditje me sende, goditje me grushta, shqelma, etj.)</p> <p>__ Arratisje (ilqja nga dhoma, etj.)</p> <p>__ Tjetër: Agresion përkundrejt vetes</p>	<p>__ Riudhëzim verbal</p> <p>__ Injorim</p> <p>__ Shpërblim</p> <p>__ Përsëritje e kërkesës</p> <p>__ Ndërprerje e detyrës</p> <p>__ Ndalim i sjelljes</p> <p>__ Sjellja përshkallëzohet</p> <p>__ Fiton akses në aktivitetet</p> <p>__ Vëmendje e fituar nga stafi/të tjerët</p> <p>__ Tjetër: qetësim dhe rikthim në angazhimin e lënë në gjysëm.</p>
<p>Kohëzgjatja e ngjarjes: 7 minuta</p> <p>__ Jepet detyra</p> <p>__ Drejtuesi kërkon të bëhet një detyrë</p> <p>__ Asnjë aktivitet</p> <p>__ Koha e zgjimit</p> <p>__ Pa vëmendje</p> <p>__ Tjetër: e angazhuar dhe e kenaqur me aktivitetin</p>	<p>__ Refuzim (injoron udhëzimet)</p> <p>__ X_ Agresion verbal (bërtitje)</p> <p>__ X_ Të qara</p> <p>__ X_ Ankesa për dhimbje</p> <p>__ Shkatërrim i pronës (prishja e sendeve, hedhja e gjërave, përplasja e dyerve, etj.)</p> <p>__ X_ Agresion kundër të tjerëve (shtyrje, goditje me sende, goditje me grushta, shqelma, etj.)</p> <p>__ Arratisje (ilqja nga dhoma, etj.)</p> <p>__ Tjetër: dominon agresioni përkundrejt të tjerëve (terapistes dhe mbështetëses së kuzhinës)</p>	<p>Riudhëzim verbal</p> <p>__ Injorim</p> <p>__ Shpërblim</p> <p>__ Përsëritje e kërkesës</p> <p>__ X_ Ndërprerje e detyrës</p> <p>__ Ndalim i sjelljes</p> <p>__ X_ Sjellja përshkallëzohet</p> <p>__ Fiton akses në aktivitetet</p> <p>__ Vëmendje e fituar nga stafi/të tjerët</p> <p>__ Tjetër: Qetësim pas 5 minutash.</p>

Aneks V

Format për Sjelljen Problematike

Emri i Fëmijës: K.M

Data: 04/09/2017

Sjellja Problematike: Shfaqja e sjelljeve aggressive si një formë për të shfaqur dhimbjet.

	Kur? (Koha dhe dita)	Ku? (Vendi-dhoma e mësimit/mjedisi sportive, etj))	Kush? (kush është zakonisht prezent)
Ka shumë gjasa të ndodhë:	Në cdo orë dhe pa parashikim	Sjellja e saj nuk lidhet me një vend të caktuar dhe ka gjasa të ndodhi në secilin vend ku qëndron gjatë ditës.	Terapistja e grupit
Ka pak gjasa të ndodhë:	Nuk ka një kohë kur mund të jetë konstatuar se ishte më e qetë. Pamvarësisht kohës episode ishin të përsëritura nga mëngjesi deri në kthimin sërish në familje	Në secilin ambient K ka shfaqur episode të sjelljes së mësipërme.	Terapistja e grupit
Ka ndodhur për herë të parë:	Ditën e hënë në mëngjes	Në familje dhe ne e kemi konstatuar në autobus duke ardhur për në qëndëer	Terapistja e grupit Mbështetësja e transportit.

Nëse fëmija përdori fjalët në vend të veprimeve, çfarë mendoni se po përpiqej të thoshte kur kryente sjelljen?

A verbalizoi në disa moment të vështira ka-ko-ko-ka dhe e shoqëroi me xheste duke prekur ballin me gisht në mënyrë të përsëritur. U ofrua mbështetje për këtë detaj duke u konsultuar patjetër edhe me prindin por nuk dha efekt pasi sjellja vazhdoi të ishte edhe më intensive.

Çfarë u përpoq të arrinte dhe me çfarë rezultatesh?

K u përpoq të tregoj shqetësimin e saj fizik (dhimbje dhe shqetësim të kokës) E realizoi duke e treguar me gisht, pastaj me fjalë dhe ajo që vura re ishte edhe kontakti me sy. K mu drejtua duke më treguar dhe pasi po përpiqesha ta qetësoj duke e mbështetur emocionalisht, duke i ofruar mundësinë për ta

nxjerrë nga ambjenti në ambjent tjetër më relaksues ajo refuzoi dhe e rriti agresivitetin dhe tensionin edhe përkundrejt meje. Përmes përshkallëzimit të sjelljes arriti të bënte të qartë shqetësimin e saj. Sjellja e saj ishte bërë e dukshme edhe në ambjentin e familjes por nuk e kishim këtë informacion që në mëngjes. Pasi prindërit u informuan në mënyrë të hollësishme, erdhën e morën dhe menjëherë K shkoi të bëjë një vizitë të specializuar lidhur me shqetësimet e saj

Aneks VI

Formati i Vlerësimit të Mjedisit

Ky format përdoret për vlerësimin e mjedisit dhe ndikimin e tij mbi sjelljen e fëmijës dhe duhet përdorur në kombinim me vlerësimin efunksionit të sjelljes dhe informacione të tjera që do të ndihmojnë në zhvillimin e strategjive të ndërhyrjes. Ky format përdoret pasi sjellja është përcaktuar qartë dhe në mënyrë konkrete. Mjedis këtu nënkupton mjedisin ku sjellja ndodh më shpesh.

- Janë plotësuar nevojat bazike të fëmijës (ushqim, krevati, shëndeti, higjena)
A ka ngrënë ushqim, nuk kabërë gjumë të rregullt gjatë natës dhe duket sikur shfaq shqetësime të lidhura me shëndetin.
- I është siguruar mbikqyrje fëmijës në këtë kohë?
Po i është ofruar jo vetëm për ta mbështetur por edhe për të vlerësuar në detaje sjelljen në mënyrë që të kuptohet edhe funksioni i saj. K ashtu si edhe pjesa tjetër e grupit janë të mbikqyrur gjatë gjithë kohës.
- Janë kujdestarët/et në dijeni për nevojat/kushtet ku ndodhet fëmija?
Është komunikuar edhe me familjen dhe u informuam se shqetësimet kanë nisur ditë më herët në familje.
- Kanë kujdestarët/et marrëdhënie pozitive/mbështetëse me fëmijën?
Në cdo moment përpiqen të krijojnë një qasje pozitive me fëmijën. Edhe në moment të vëshitra ku po dëmtohem fizikisht sërisht përpiqem të jem neutral, mos shfaq shqetësim dhe të arrij ta qetësoj K.
- Komunikojnë në mënyrë efektive kujdestarët/et me fëmijën?
Komunikimi është element bazë në ndërtimin e një marrëdhënie të shëndetshme mes perfituesve dhe stafit. Trajnimet kanë ngritur kapacitetet dhe në aspektin e komunikimit tregohet kujdes nga secili.
- Kanë kujdestarët/et pritshmëri pozitive realiste për sjelljen e fëmijës?
Në diskutimet rreth problematikave dhe shqetësimeve, gjithmonë stafi tregon pritshmëri dhe është në kërkim të qasjeve të cilat mund ti përmbushin ato.
- A kanë kujdestarët/et kohën/energjinë/motivimin/njohuritë&aftësitë për të zbatuar strategjinë ndërhyrjes (nëse ka një të tillë)?
Jo gjithmonë është e mundur që sjelljen ta rregjistrosh në moment pas

qetësimit kuptohet por mund të gjendet koha dhe hapsira për të mbajtur shënimet dhe detaje doethënëse.

- A mund të shohë fëmija model pozitiv të sjelljes së dëshirueshme gjatë gjithë kohës/rregullisht?
Në trajtimin që i ofrohet tregohet profesionalizëm dhe një model i sjelljes që vlerësohet si pozitiv dhe që në punohet në drejtim të modifikimit të sjelljes së papaërshtatshme nga ana e fëmijës
- Deri në ç'shikallë mundet fëmija të parashikojë dhe të kontrollojë ngjarjet menjëherë në mjedisin ku ndodhet?
Sjellja duket sikur nuk kontrollohet nga ana e K. Edhe pse bëhet ndërhyrje nga terapistja në fakt duket sikur K merr kohë deri në qetësimin e dhimjeve.
- A është fëmija i kënaqur në mjedisin ku ndodhet? Mos po ndodh ndonjë gjë tjetër shqetësuese/stresuese në jetën e tij/saj?
Nga konstatimet e familjarëve por edhe nga vëzhgimi dhe vlerësimi i sjelljes përjetimi i shqetësimeve fizike është i dukshëm. K është në moshën e adoleshencës dhe sigurisht që kjo periudhë shoqërohet edhe me shqetësime emocionale për të cilat është treguar kujdes në mënyrë të vazhdueshme nga na e stafit por edhe shoqëruar me keshilla për trajtimin e saj në ambjentin e familjes.
- Cilat janë pasojat/implikimet më të mëdha të sjelljes problematike?
Qetësimi i dhimbjeve fizike të lajmëruara prej saj përmes formave të sjelljes të parashtruara më sipër është prioritet. Agresiviteti ndaj vetes por edhe ndaj stafit apo përfituesve të tjerë gjithashtu është një sjellje e cila kërkon ndërhyrje të menjëhershme.
 - Është në të mirën e fëmijës të ndryshojë sjelljen?
Patjetër që po. Edhe në këto kushte sapo qetësohet përfshihet në program aty ku e la por nëse do të jetë e qetë normalisht do mund të përfitoj më tepër nga programet e fokusuara në secilën fushë sikurse e parashikon edhe program i specializuar.
 - A fiton ndonjë person/njësi tjetër nga ndryshimi i sjelljes/ ose mosndryshimi i saj.
Përfituesit të cilët janë pjesë e grupit do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me qetësimin e K.
Terapistja gjithashtu do mund të përqëndrohet më tepër e do mund ta realizojë programin me më shumë efektivitet.

Aneks VIII

Formati i kohës kur ndodh sjellja

Fëmija: K. M

Muaji/Viti: Shtator 2017

Sjellja: Shfaqja e sjelljeve aggressive si një formë për të shfaqur dhimbjet

_____ _____ _____

Data	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
6:00																															
6:30																															
7:00																															
7:30																															
8:00				X																											
8:30																															
9:00																															
9:30				X																											
10:00				X																											
10:30																															
11:00																															
11:30																															
12:00																															
12:30																															
1:00				X																											
1:30																															
2:00																															
2:30																															
3:00																															
3:30																															
4:00																															
4:30																															
5:00																															
5:30																															
6:00																															
6:30																															
7:00																															
7:30																															
8:00																															
8:30																															

9:00																									
9:30																									
10:00																									
10:30																									
11:00																									
11:30																									
12:00																									
12:30																									
1:00																									
1:30																									
2:00																									
2:30																									
3:00																									
3:30																									
4:00																									
4:30																									
5:00																									
5:30																									

Aneks IX

Shkalla e Vlerësimit të Motivit

Shkalla e Vlerësimit të Motivit ndihmon që stafi të vlerësojë motivin pse fëmija kryen një sjellje të caktuar.

Emri: K.M Shkalla: _____ Data: 18/09/2017

Emërtoni dhe përshkruani sjelljen: Sjellje aggressive ndaj vetes dhe stafit

Pyetjet	Asnjë-herë	Pothuajse asnjëherë	Rrallë	Gjysmën e kohës	Zakonisht	Pothuajse gjithmonë	Gjithmonë
	0	1	2	3	4	5	6
1. Do të ndodhte sjellja në mënyrë të vazhdueshme nëse fëmija lihej vetëm për periudha të gjata kohe?					X		
2. A ndodh sjellja pas një kërkesë që e ngarkon fëmijën me detyrë të vështirë?		X					
3. Ndodh sjellja si përgjigje ndaj bashkëbisedimit tuaj (stafit) me fëmijë/staf të tjerë në dhomë/zonë?	X						
4. A ndodh sjellja për të marrë një lodër, ushqim, ose një aktivitet ku është thënë që nuk mund ta ketë/nuk mund të marrë pjesë?		X					
5. A do të shfaqej sjellja në mënyrë të përsëritur, në të njëjtën mënyrë, për periudhë të gjatë kohe, nëse fëmija do të ishte vetëm? (psh. përplasia para/mbrapa për 1 orë).					X		
6. A shfaqet sjellja kur fëmija bën ndonjë kërkesë?			X				
7. A shfaqet sjellja kur ju ndaloni së ndjekuri fëmijën?		X					
8. A shfaqet sjellja kur ju i merrni një ushqim, lodër, apo nuk e lejoni të bëjë një aktivitet?			X				

9. Ju duket sikur fëmija kënaqet duke e bërë sjelljen? (Ndjehet, shijon,duket, nuhatet, dhëgjohe si kënaqësi)	X						
10. A duket se fëmija e bën sjelljen për t'ju shqetësuar/mërzitur kur i kërkoni të bëjë atë që i keni kërkuar?	X						
11. A duket se fëmija e bën këtë sjellje për t'ju shqetësuar apo mërzitur kur ju nuk i kushtoni vëmendje? (psh. kur jeni duke folur me dikë tjetër)	X						
12. A ndalon sjellja menjëherë pas ii jepni ushqimin, lodrën apo aktivitetin e kërkuar (nga fëmija)?			X				
13. Kur ndodh sjellja a duket se fëmija është i qetë dhe i pavetëdijshëm se çfarë ndodh rrotull tij/saj?					X		
14. A ndalon sjellja menjëherë (1-5 min) pasi ju ndaloni së punuari/ bëri kërkesa ndaj fëmijës?			X				
15. A duket se fëmija bën sjelljen se do që të shpenzoni kohë me të?		X					
16. A ndodh sjellja kur fëmijës i thuhet se nuk të bëjë diçka që do ta bëjë?		X					

Aneks X

Analiza dhe Përmbledhja e Shkallës së Vlerësimit të Motivit

Fëmija : _____ Data: _____

Sjellja problematike: Shfaqja e sjelljeve aggressive si një formë për të shfaqur dhimbjet

Vendi: _____

Niveli	Shqisore	Arratisje	Vëmendje	Sjellje e qëllimshme
Mediana e nivelit:				

Pasi të keni vlerësuar çdo format të Shkallës së Vlerësimit të Motivit, vendosni nivelin (duke filluar nga 1 më i lartë te 4 më i ulët) në kolonën përkatëse të funksionit. Pasi keni hedhur të gjitha nivelet për funksionet e sjelljes, shënoni në rreshtin "Mediana e nivelit) mesataren e të gjitha vlerësimeve që keni vendosur në kolonën e çdo funksioni. Rrethoni funksionin/motivin që rezulton të përmbushë kjo sjellje.

Funksioni (et) më të mundura: _____

Aneks XI

Pyetjet për Funkcionin e Sjelljes

Emri i fëmijës: K.M

Data: 18/09/2017

Emri i stafit që plotëson formatin: Terapistja e grupit

Emërtimi i problemit dhe përshkrimi: Shfaqja e sjelljeve aggressive si një formë për të shfaqur dhimbjet

Përdorni shkallën se kur e kryen sjelljen fëmija në situatat e përshkruara.

X	0	1	2	3
Përrjashtohet	Asnjëherë	Rrallëherë	Disa herë	Shpeshherë

- __X__ 1. E bën sjelljen për të marrë vëmendje.
- __X__ 2. Përfshihet në sjellje që t'i shmanget punës ose situatave ku duhet të mësojë.
- __1__ 3. Përfshihet në sjellje si një formë "vet-stimulimi".
- __3__ 4. Përfshihet në sjellje se ka dhimbje.
- __1__ 5. Përfshihet në sjellje për të fituar ushqim, lodra, pije të preferuara.
- __X__ 6. Përfshihet në sjellje se do të qortohet.
- __0__ 7. Përfshihet në sjellje kur i kërkohet të bëjë diçka (të vishet, lajë dhëmbët, punojë, etj).
- __0__ 8. Përfshihet në sjellje kur mendon se nuk ka njeri në dhomë.
- __3__ 9. Përfshihet në sjellje më shumë kur është sëmurë.
- __0__ 10. Përfshihet në sjellje kur i merrni diçka.
- __0__ 11. Përfshihet në sjellje kur do të tërheqë vëmendjen ndaj vetes.
- __1__ 12. Përfshihet në sjellje kur nuk do të bëjë diçka.
- __1__ 13. Përfshihet në sjellje kur nuk ka asgjë tjetër për të bërë.
- __3__ 14. Përfshihet në sjellje kur e shetëson diçka fizikisht.
- __1__ 15. Përfshihet në sjellje kur ju/të tjerët kanë diçka që ai/ajo e do.

- ___2___ 16. Përfshihet në sjellje kur do të marrë reagim nga ju.
- ___0___ 17. Përfshihet në sjellje kur do që të tjerët ta lënë rehat.
- ___3___ 18. Përfshihet në sjellje në mënyrë përsëritëse, duke injoruar mjedisin që e rrethon.
- ___3___ 19. Përfshihet në sjellje sepse fizikisht nuk është rehat.
- ___1___ 20. Përfshihet në sjellje kur një fëmijë tjetër ka atë që ai/ajo do.
- ___1___ 21. Duket sikur thotë “hajde më shih” ose “më shih” kur është duke kryer sjelljen.
- ___3___ 22. Duket sikur thotë “më lër rehat” ose “mjaft më kërkove të bëj këtë” kur është duke kryer sjelljen.
- ___x___ 23. Duket sikur kënaqet duke u sjelle në atë mënyrë, edhe kur nuk ka njerit tjetër në dhomë.
- ___3___ 24. Duket sikur nëpërmjet sjelljes do të tregojë që nuk ndjehet mirë.
- ___1___ 25. Duket sikur thotë “ma jep atë (lodër, ushqim, pije, etj) kur përfshihet në sjellje.

Aneks XII

Rezultatet për pyetjet e funksionit të sjelljes

Emri i fëmijës: K. M

Data: 18/09/2017

Emri i stafit që plotëson formatin : Terapistja e Grupit

Sjellja problematike dhe përshkrimi: Shfaqja e sjelljeve aggressive si një formë për të shfaqur dhimbjet

Vëmendja

Pikët

1. E bën sjelljen për të marrë vëmendje.	X
6. Përfshihet në sjellje se do të qortohet.	X
11. Përfshihet në sjellje kur do të tërheqë vëmendjen ndaj vetes.	0
16. Përfshihet në sjellje kur do të marrë reagim nga ju.	1
21. Duket sikur thotë "hajde më shih" ose "më shih" kur është duke kryer sjelljen.	1
Pikët total	2

Arratisja

2. Përfshihet në sjellje që t'i shmanget punës ose situatave ku duhet të mësojë.	X
7. Përfshihet në sjellje kur i kërkohet të bëjë diçka (të vishet, lajë dhëmbët, punojë, etj).	0
12. Përfshihet në sjellje kur nuk do të bëjë diçka.	X
17. Përfshihet në sjellje kur do që të tjerët ta lënë rehat.	0
22. Duket sikur thotë "më lër rehat" ose "mjaft më kërkove të bëj këtë" kur është duke kryer sjelljen.	1
Pikët total	2

Sjellje jo-sociale

3. Përfshihet në sjellje si një formë "vet-stimulimi"	1
8. Përfshihet në sjellje kur mendon se nuk ka njeri në dhomë.	0
13. Përfshihet në sjellje kur nuk ka asgjë tjetër për të bërë.	1
18. Përfshihet në sjellje në mënyrë përsëritëse, duke injoruar mjedisin që e rrethon.	3
23. Duket sikur kënaqet duke u sjellë në atë mënyrë, edhe kur nuk ka njeri tjetër në dhomë.	0
Pikët total	5

Fizike

4. Përfshihet në sjellje se ka dhimbje.	3
9. Përfshihet në sjellje më shumë kur është sëmurë.	3
14. Përfshihet në sjellje kur e shetëson diçka fizikisht.	3
19. Përfshihet në sjellje sepse fizikisht nuk është rehat.	3
24. Duket sikur nëpërmjet sjelljes do të tregojë që nuk ndjehet mirë.	3
<u>Pikët total</u>	15

Sjellje të qëllimshme

5. Përfshihet në sjellje për të fituar ushqim, lodra, pije të preferuara.	1
10. Përfshihet në sjellje kur i merrni diçka.	0
15. Përfshihet në sjellje kur ju/të tjerët kanë diçka që ai/ajo e do.	1
20. Përfshihet në sjellje kur një fëmijë tjetër ka atë që ai/ajo do.	1
25. Duket sikur thotë “ma jep atë (lodër, ushqim, pije, etj) kur përfshihet në sjellje.	1
<u>Pikët total</u>	4

Aneks XIII

Formati i Raportimit të Incidenteve

Emri i fëmijës: K. M

Data: 18/09/2017

Emri i stafit që plotëson formatin : Terapistja e grupit

Sjellja e rrezikshme: Shfaqja e sjelljeve aggressive si një formë për të shfaqur dhimbjet

Përshkrimi i ngjarjes: Sjellja aggressive ndaj vetes dhe stafit u evidentua që në momentin kur K hipi në autobus për të shkuar në qëndër. Në moment prindërit përmendën se nuk ka qënë e qetë por kjo vjen si pasojë e kërkesave të saj të vazhdueshme të cilat kishin vendosur mos ia plotësonin nga ky moment. Ndërkohë teksa u fut në klasë dhe hoqi xhupin u evidentuan nga terapistja shenja piskimesh/kafshime në të dy krahët e saj. K për një moment nisi sërish të qajë, të bërtas dhe të pickojë e kafshojë dorën fort ku me dorën tjetër përmendte koka-koka. Pas pak sekondash u bë aggressive edhe me terapisten duke e pickuar dhe shtrënguar fort. U mblodh menjëherë ekipi, u komunikua me prindërit të cilët shprehën se janë në dijeni të situatës.

Objekte të rrezikshme të përfshira:

Nuk ka objekte. Dëmtimet i shkaktonte përmes pickimeve, kafshimit, goditjeve, përplasjeve me duart e saj.

Masat e marra:

Sapo u konstatua se vajza dëmtonte veten në mënyrë të vazhdueshme dhe kishte dëmtime të dukshme u komunikua me prindërit e saj. Prindërit u pyetën lidhur me situatën e vajzës dhe u kërkua takim i menjëhershëm. Pas takimit prindërit u bindën për të bërë disa kontrolle mjekësore që mund të ndikojnë në qetësimin e vajzës.

Nevoja shëndetësore të fëmijës:

K kishte nevojë të bënte vizitë mjekësore lidhur me shqetësimet fizike që kishte disa ditë që i shfaqte.

Ndihmë shëndetësore e marrë (nëse ka pasur nevojë):

Prindëritu konsultuan me mjekun dhe u ndoqën më tej këshillat të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e shëndetit të vajzës.

Punonjësit prezentë në marrjen e masave:

1. Terapistja e grupit
2. Psikologjia

Aneks XIV

Formati i Dokumentimit të Kohës së Veçimit

Emri i fëmijës: _____ Data: _____

Emri i stafit që plotëson formatin: _____

Sjellja e rrezikshme: _____

Përshkrimi i sjelljes:

Koha e fillimit të veçimit:

Koha e përfundimit të veçimit:

Emri i stafit që mbikqyri fëmijën:

Nevoja shëndetësore të fëmijës gjatë veçimit:

Nevoja shëndetësore të fëmijës pas veçimit:

Ndihmë shëndetësore e marrë (nëse ka pasur nevojë):

Punonjësit prezentë në marrjen e masës së veçimit:

1. _____
2. _____

Rasti Nr. 2

Aneks II

Përmbledhja e modelit të Vlerësimit FunkSIONAL të Sjelljes

Mbledhja e informacionit ndihmon për hartimin e një plani për ndryshimin e sjelljes. Ky informacion duhet të mblidhet nga punonjësit që janë në kontakt me fëmijën, në bashkëpunim me terapistin e sjelljes dhe prindërit/kujdestarët.

Pyetjet e mëposhtme ndihmojnë për të marrë informacionin e nevojshëm që do përdoret për analizën e sjelljes:

- **Cila është sjellja? Vëzhgoni, emërtoni dhe përshkruani sjelljen.**
A ka filluar të shfaqë agresivitet të shtuar ndaj shokëve dhe terapsites përmes piskimeve, kafshime, goditje, shtyrje dhe hedhje të objekteve. Vihet re një luhatje e gjendjes së tij emocionale që ndryshon shumë shpejt në kohë. Agresiviteti dhe shprehja e afeksionit përmes përqaftimeve janë prezente në mënyrë të vazhdueshme në grup. A ka tendencë të shmangi pjesëmarrjen dhe nagazhimin në program. Si fillim nisi të refuzojë anagazhimin personale dhe ditë pas dite tenton të pengojë edhe programin e grupit. A nervozohet shumë shpejt dhe kërkon një kohë të gjatë për tu qetësuar. Karakteristikë e sjelljes së tij është edhe ruajtja e inattit gjatë në kohë dhe kjo e bën edhe më të vështirë manaxhimin e tij.
- **Ku ndodhi sjellja? Përshkruani vendin apo mjedisin ku ndodhi sjellja.**
Sjellja ndodhi në klasën ku zhvillohet terapia e grupit por nuk mungojnë episode edhe në ambiente të tjera teksa i kërkohet të bëjë dicka.
- **Kush u përfshi në kohën kur ndodhi sjellja? Shkruani emrat e personave që ishin në mjedis para, gjatë dhe pas shfaqjes së sjelljes.**
U përfshi terapistja e grupit dhe fëmijët që ishin present.
- **Kur ndodhi sjellja? Përcaktoni kohën kur sjellja shfaqet zakonisht.**
Sjellja ndodhi në momentin kur iu kërkua të mbledhi mjetet që punoi në tavolinë(mjete me te cilat dëshiron të merret gjatë gjithë kohës) dhe ti vendosi në dollap, pasi ka rënë zilja për të dhënë mesazhin se ky program u mbyll e pas një pushimi të shkurtër do filloj programi i ri.

- **Pse ndodhi sjellja? Bëni hipoteza për funksionet ose shkaqet e sjelljes.**
Përmes kësaj sjellje A shmang angazhimin.
A në momente të caktuara të krijon përshtypjen se nuk ka durimin dhe përqëndrimin emjaftueshëm për tu angazhuar në program pasi edhe kur pëërpiqet mundet shumë pak në kohë.
- **Përcaktoni çfarë ndodhi para dhe pas shfaqjes së sjelljes.**
Para sjelljes iu adresua një komandë verbale, dhe pas sjelljes A zgjodhi të shkojë të ulet mbi top në heshtje dhe me vigjëlencë të lartë e pas kësaj u shtri në tapet duke parë nga grupi gjithë lëvizjet dhe veprimet. Refuzues në cdo moment
- **Merrni në konsideratë funksione të ndryshme të sjelljes. Studiuesit kanë përcaktuar tre funksione kryesore të sjelljeve sfiduese: 1) për të marrë vëmendje ose gjëra të tjera të dëshiruara (dëshira dhe nevoja); 2) për të shmangur ngjarje ose aktivitete të padëshiruara; 3) si një përgjigje ndaj përjetimit fizik ose ndjesor (dhimbje, mosrehati ose për t'u ndjerë mirë).**
- **Sa shpesh ndodh sjellja problematike?**
Sjellja përsëritet 3- 4 herë përgjatë ditës në programme të ndryshme.
- **Çfarë ndodh kur fëmijës i mësohet një sjellje zëvendësuese/e re, kur mjedisi ndryshon ose faktorët nxitës largohen?**
Vihet re se efektet janë shumë të vogla dhe se A është shumë rezistent në agresivitetin që shfaq. Është provuar ti komunikohet me një zë dhe intonacion më të kujdesshmë, më të qetë megjithatë ai është rezistent dhe nuk është gati të bashkëpunojë pamvarësisht kushteve të përshtatura.

Aneks III

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike ndihmon në përcaktimin e faktorëve nxitës dhe pasojën/shpërblimin që merr fëmija nga një sjellje që mund ta përforcojë ose ta mbajë sjelljen problematike.

Emri i fëmijës: A.SH.

Data	Koha	Stafi	Faktori Nxitës (Çfarë ndodhi më parë?)	Sjellja (Përkruani sjelljen)	Pasoja/Shpërblimi (Çfarë ndodhi më pas?)
04/09/2017	Në fund të programit kur fëmijët punojnë individualisht në tavolina	Terapistja e grupit	Iu kërkua verbalisht të vendosi mjetet në dollap pasi programi mbaroi	Nis të kontraktohet, ngrihet nga tavolina dhe bën disa lëvizje kaotike dhe menjëherë pas kësaj shkon tek fëmija më i afërt dhe e qëllon.	Fëmijët reagojnë të trembur, E nis të qajë ndërsa A kthehet në tavolinë, shikon lodrat e hedhura përtok dhe mban një qëndrim aspak bashkëpunues. Si fillim ruajta qetësinë, u kujdesa të shoh fëmijën që u goditi dhe më shumë qetësi u afrova A-së për ti kërkuar të mbledhi mjetet dhe më pas të përfojoj shokun që goditi. A u bë agresiv edhe me mua dhe nuk dëshiron të bashkëpunojë; është rezistent ndaj komandës
04/09/2017	Në kohën e ngrënies në mensë	Terapistja e grupit	Terapistja i qëndron pranë tavolinës së ngrënies dhe e nxit verbalisht të hajë ushqimin me dorën e tij.	A u ngrit, filloi të pickojë, të kapi nga flokët dhe në atë moment është shumë konfuz, shikimi i pakordimuar, me kontraktime të trupit.	Më pas u qetësua por A refuzoi ta hajë ushqimin dhe madje tërhoqte terapisten nga dora që ajo ta ushqejë dhe jo ai i pavarur edhe pse mundet ta realizojë mjaft mirë këtë sjellje. A tentoi serisht të jetë agresiv

04/09/2017	Në kohën pas drekës kur fëmijët konsu- mojnë gjëra të vogla të marra nga shtëpia	Terapistja e grupit	A pa shokun që po hante një ushqim të preferuar dhe në atë moment po e ndiqte me sy	A menjëherë i mori ushqimin, dhe e qëlloi pas reagimit të fëmijës për të mbrojtur ushqimin e tij.	Me qetësi, i kërkova ta kthente ushqimin dhe instruktova A ta kërkoi ushqimin me gisht dhe fëmijën tjetër ti japi pak me dëshirën e tij e ne fund të përqafohen.A përiti, e mori ushqimin dhe më pas e goditi sërisht shokun, pasi inati i tij ruhet gjatë në kohë.
04/09/2017	Në programin e muziko- terapisë	Terapistja e grupit	I kërkova të bashkohet më grupin në kërcim por A kërkoi të dëgjojë në mënyrë të përsëritur të njëfjën këngë dhe qëndron tek majetofoni për të plotësuar dëshirën e tij duke mos u bërë pjesë e aktivitetit të përbashkët	Nuk pranon dhe menjëherë reagimi i tij është sulmues ndaj personit më të afërt që kishte aty dhe më pas u terhoq menjëherë për te tavolina ku është majetofoni.	U vendos kënga e tij e preferuar dhe me pak nxiqe i kërkova të kërcenim bashkë duke krijuar atmosphere shumë argëtuese për të humbur vëmendjen e tij nga ajo cka kishte synim. Qëndroi 5 minuta dhe u rikthye sërisht tek magnetofoni
04/09/2017	Në kohën e përgatitjes për në shtëpi	Terapistja e grupit	Njëri prej fëmijëve nisi të qajë.	A i shkoi afër e pickoi fort dhe e shtyu. Pastaj menjëherë shkoi të ulej tek top i preferuar duke pritur reagimin pasi ekuupton kur bën gabim.	Me shumë kujdes i kërkova të qetësohej dhe se shokun e kemi xhan. I kërkova të ngrihej ta perqafonte se ai është i mërziur dhe a e puthi por dhe e shtyu tekta u largua.

Aneks III

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike ndihmon në përcaktimin e faktorëve nxitës dhe pasojën/shpërblimin që merr fëmija nga një sjellje që mund ta përforcojë ose ta mbajë sjelljen problematike.

Emri i fëmijës: A.SH.

Data	Koha	Stafi	Faktori Nxitës (Çfarë ndodhi më parë?)	Sjellja (Përshkruani sjelljen)	Pasoja/Shpërblimi (Çfarë ndodhi më pas?)
05/09/2017	Gjatë ecjes në corriddor për tu future në klasë në mëngjes	Terapistja e grupit dhe stafe të tjera	A iu kërkua të kapet nga dora me shkoun dhe të ecin për në klasë	A u revoltua, iu drejtua shokut duke e pickuar atë, e qëlloi dhe më pas eci me vrap në drejtim të klasës	Në momentin kur u bashkuam të gjithë në klasë ai priste një reagim pasi e kuptoi veprimin që bëri por thjesht e injorova dhe i komunikova të heqi cantën/ këpucët dhe të ulet. Vazhdoi të bëjë veprimet por nuk u qetësua plotësisht.
05/09/2017	Në programin e autonomisë	Terapistja e grupit	Ashtu si edhe fëmijëve të tjerë iu kërkua të marrin karriket personale dhe të afrohen në tavolinën e përbashkët	A u shqetësua,duart i kontrakttoi në formë refuzimi dhe teksa iu drejtova për ta nxitur të ngrihej më kapi nga flokët dhe më pickoi.	Në atë moment ruajta qetësinë dhe me kujdes duke i komunikuar qetë i kërkova të heqi dorën sepse më dhemb. Ai vazhdoi të jetë i axhituar edhe pse më lëshoi vazhdoi të mbajë inat dhe ishte mjaft rezistent /refuzoi të bashkohenj me shokët I komunikova se do qëndroj aty sa të qetësoheej dhe pastaj do vazhdojmë mësimin prap.

05/09/2017	Në programin e autonomisë sërisht	Terapistja e grupit	A po qëndronte në tavolinën e tij ashtu i shpërqëndruar dhe me disa lëvizje të trupit të pakordinuara. Ndërkohë fëmijët po vazhdonin programin	A u ngrit nga tavolina individuale dhe shkoi të ullej mbi topin e vendosur pas derës në cep të klasës. Me shumë qetësi i kërkova të bashkohen duke lëvizur një karrike në formë ftese dhe nxitje njëkohësisht. A u ngrit në një moment, u afrova tek shoku e puthi në kokë dhe para se të largohej shpejt e shpejt e shtyu atë.	Me shumë qetësi shkova tek A dhe i zgjata dorën por reagimi ishte sërisht një shpërthim agresiv me pickime, tentative për të më kafshuar dhe kapje e flokëve.
05/09/2017	Në palestër	Terapistja e grupit	A u pozicionua tek bicikleta dhe nuk po e përdorte thjeshtë qëndronte në këmbë pranë saj Ndërkohë fëmijët ishin vendosur në rjesht tek trau i ekuilibrit dhe po zhvillonin programin Iu kërkua A-së të bashkohet me grupin	Në fillim nuk reagoi fare thjeshtë qëndroi në vend dhe sapo fëmijët u afruan pranë tij nisi ti sulmojë duke tentuar ti shtyjë	Në atë moment u kujdesa për fëmijët të cilët u friksuan dhe pas pak u afrova A për ta ftuar në një lojë me balonë. A u argëtua për 2 minuta dhe më pas më shtyu duke më dhënë mesazhin se nuk dëshiroi të vazhdojë më tepër. E lash të qetësohej duke e orientuar të zgjedhi ai vetë me çfarë do luajë por sërisht ai refuzoi duke qëndruar në vend dhe duke vëzhguar çfarë ndodh rreth e rrotull.

Aneks III

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike ndihmon në përcaktimin e faktorëve nxitës dhe pasojën/shpërblimin që merr fëmija nga një sjellje që mund ta përforcojë ose ta mbajë sjelljen problematike.

Emri i fëmijës: A.SH.

Data	Koha	Stafi	Faktori Nxitës (Çfarë ndodhi më parë?)	Sjellja (Përshkruani sjelljen)	Pasoja/Shpërblimi (Çfarë ndodhi më pas?)
06/09/2017	Në autobus gjatë transportit	Terapistja e grupit Mbështetësja në transport	A erdhi i acarruar duke shfaqur shpërthime agresiviteti ndaj nënsë teksa po e shoqëronte për në autobus.	Menjëherë sapo u fut në autobus nisi të sulmojë stafin dhe fëmijët që i kishte pranë.	Mora pak kohë, rreth 2-3 minuta, dolëm jashtë që të qetësohej, ndërkohë ai vazhdoi të ishte agresiv, duke pickuar/kafshuar/ shtyrë/kapur nga folët dhe me të qara. U kujdesa mos më dëmtojë dhe njëkohësisht përmes një reagimi shumë neutral u përpoqa ta qetësoj. I shpreha se më dhëmb dora/ folkët dhe njëkohësisht i mbajta pas vetes sa ait ë qetësohej.u qetësua disi dhe vazhduam por duke e patur në vëmendje.
06/09/2017	Në klasë, teksa po konsumonin ushqimet e marra nga shtëpia	Terapistja e grupit	Secili fëmijë ishte ulur në tavolinën e tij dhe ishin mjaft të qetë dhe të fokusuar tek ushqimi.	A u ngrit menjëherë nga tavolina në drejtim të shokut që po ha biskota. Menjëherë ia mori nga tavolina dhe e shtyu duke ikur me vrap	Qetësisht shkova tek A, i kërkova tia ktheje biskotën shokut. Përmes komunikimit se duhet ta kërkojmë bukur A u bë agresiv dhe pati një shpërthim të menjëhershëm. Ishte i shpërqëndruar dhe nuk ka durim as të dëgjojë teksa if let dhe as të angazhohet.

06/09/2017	Në pushimin e tranzicionit të programeve.	Terapistja e grupit	Fëmijët ishin në këmbë duke lëvizur nëpër klasë të lirë bashkë edhe me A.	Papritur A filloi tu afrohet fëmijëve me rradhë duke i puthur tek koka megjithëse ata u ndjen edhe të frikësuar në një moment. Tek ënjia i fundit e puthi dhe duke u larguar e kapi nga flokët dhe nisi të axhitohej. Menjëherë ndërhyra për tu kujdesur për fëmijën por A reagoi njësoj edhe me mua	E njëjta praktikë. U përpoqa ta qetësoj duke ia mbajtur duart lehtësisht dhe duke e orientuar për tu ulur në tavolinë. Gradualisht u qetësua , mori karriken dhe më pas u ulëm në tavolinën e aktivitetit në grup.
06/09/2017	Përgjatë ngrënies në mensë	Terapistja e grupit Terapistja individuale	Fëmijët po konsumonin ushqimin. A iu kërkua të bëjë kërkesë për ushqim përmes pikturave PECS.	Reagoi në mënyrë aggressive. Pati një shpërthim të papritur duke flakur pikturat dhe duke pickuar/ tentative për të kapur nga flokët/ shtyu tavolinën me këmbë etj	Në këto kushte ishte hsumë e rëndësishme të ruajta qetësinë dhe duke u kujdesur për veten dhe për fëmijët të cilët mund ti sulmonte në një moment nisa ti komunikojta të qetësohej si fillim. Më pas u shkpëuta dhe e lash disa minuta pa i folur derisa u qetësua plotësisht dhe nisi të hajë ushqimin me nxitje fizike dhe verbale.
06/09/2017	Në programin e punës së pavarur në tavolinë	Terapistja e grupit	Secili prej fëmijëve u instruktua të shkojë në dollap dhe të marrim mjete e punës. Komanda iu adresua edhe A-së me një zë tëpër të qetë .	A u ngrit, shkoi në dollap, kërkoi një kuti me objekte të imta por nuk e gjeti (është hequr pasi preferon të qëndrojë gjatë gjithë kohës me këto objekte dhe refuzon të jetë pjesë e programit). Meqë nuk e gjeti, hodhi disa objekte nga dollapi në tokë dhe menjëherë hapi derën dhe shkoi në klasën e terapisë individuale për ta kërkuar.	I kërkova terapistes ta udhëzojë për tu rikthyer në klasë. A u kthye i revoltuar dhe duke refuzuar cdo angazhim u ul mbi top. Pas 5 minutash i kërkova me qetësi të bashkohen me grupin. Erdhi dhe qëndroi pak dke u larguar sërisht për tu ulur tek topi

Aneks III

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike

Metoda ABC për analizën e sjelljes problematike ndihmon në përcaktimin e faktorëve nxitës dhe pasojën/shpërblimin që merr fëmija nga një sjellje që mund ta përforcojë ose ta mbajë sjelljen problematike.

Emri i fëmijës: A.SH.

Data	Koha	Stafi	Faktori Nxitës (Çfarë ndodhi më parë?)	Sjellja (Përshkruani sjelljen)	Pasojë/Shpërblimi (Çfarë ndodhi më pas?)
